



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 96

Prishtinë, më 27.1.2014, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S2

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi, Behar Selimi, Mufera Shinik, Arsim Bajrami, Halit Krasniqi, Ardian Gjini, Armend Zemaj, Albulena Haxhiu dhe Sreten Ivanoviq.

Munguan: Haki Demolli dhe Gëzim Kelmendi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati – ZPRK, Petrit Hysaj – OSBE, Edon Myftari – CDF dhe Vjollcë Xhota – IKPK.

Nga stafi i Komisionit për Legjislacion: Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 11 dhe 25.11. 2013;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të punës së Komisionit për vitin 2013;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2014;
5. Shkresa e Kryetarit të Kuvendit që ka të bëjë me kërkesën për veprim bazuar në raportet e fundit të ekspertëve të TAIEX-it;
6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës;
7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-197 për kimikate;
8. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari propozoi që në rend dite të përfshihen edhe:

- a. Shkresa e shoqërisë civile për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit Nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre,
- b. Njoftim me ekspertizën e Idriz Tahirit për PL për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-050 për deklarimin prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë,
- c. Njoftim me ekspertizën e Besim Kelmendit për PL për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës ose të panelit për lirim me kusht;
- d. Shkresa e Komisionit për Buxhet dhe Financa për projektligjin për deputet.

Kurse pika shtatë të hiqet nga rendi ditës, sepse nuk kemi arritur që ta analizojmë si duhet.

Kryetari konstatoi se rendi ditës miratohet me ndryshimet e propozuara.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 21.10.2013

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 11 dhe 25.11. 2013, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të punës së Komisionit për vitin 2013,

Kryetari, në pika të shkurta e paraqiti raportin e punës së Komisionit për vitin 2013, ku për ta ushtruar funksionin e përcaktuar me rregullat e Rregullores së Kuvendit, Komisioni ka shqyrtuar 6 projektligje në cilësi të Komisionit Funksional, 44 projektligje për bazë juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ia ka propozuar Kuvendit për miratim 21 amendamente. Ka bërë 55 raporte me rekomandime, prej të cilave 11 për Kuvend, 44 për komisionet kryesore dhe komisionet funksionale. Ka mbajtur 3 dëgjime publike. Ka angazhuar ekspertë për shqyrtimin e projektligjeve dhe ka formuar 7 grupe të punës. Këto grupe, në periudhën e raportimit, mbajtën 14 takime. Ka shqyrtuar shkresa, të personave fizikë, të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare dhe ka bërë kërkesa dhe njoftime për Kryesinë e Kuvendit, për subjektet që iu drejtuan këtij Komisioni dhe për instancat e pushtetit në Kosovë.

Armend Zemaj kërkoi që raportit të Komisionit për Legjislacion t'i bashkëngjitet edhe raporti i punës së Nënkomisionit për mandate, imunitete dhe rregulloren e punës.

Albulena Haxhiu shprehu shqetësimet e saj lidhur me mos realizimin e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve që shprehet edhe si mungesë në raportin e punës së Komisionit. Ajo kërkoi përkushtim më të madh të Komisionit lidhur me monitorimin e ligjeve gjatë vitit 2014.

Meqë nuk kishte vërejtje tjera, Komisionit në mënyrë unanime nxori këtë:

Përfundim

Miratohet raporti punës së Komisionit për Legjislacion, për vitin 2013

4. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2014,

Kryetari duke folur për planin e punës, i cili ju është shpërnda si draft, propozoi që në muajin mars të përfshihet Monitorimi i zbatimit të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, pasi që është pa si e nevojshme, si dhe duke pasur parasysh edhe shkresë e TAIEX-it që e kemi edhe si pikë të rendit të ditës.

Albulena Haxhiu propozoi që në muajin shtator të bëhet monitorimi i zbatimit të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale.

Arsim Bajrami duke ju referuar drafit të propozuar të planit të punës për vitin 2014, tha se me vendim të Kryesisë është ngarkuar Komisioni për Legjislacion që ta hartojë Ligjin për Kuvendin. Ai tha se nëse mendohet që kjo legjislaturë ta përfundojë këtë ligj duhet të parashohim që punën ta fillojmë në shkurt, kurse në muajin mars të jetë i përfunduar. Është mirë që ky ligj të përfundojë brenda këtij mandati, sepse të gjitha pushtetet kanë ligje të veçanta si Ligji për Qeverinë dhe ligji për gjykatat.

Kryetari duke u ndërlidhur me diskutimin e parafolësit tha se është një çështje që duhet debatuar në koncept, për faktin se kemi një rregullore bukur të detajuar, çka do të trajtojë ligji, kur e dimë që rregulloren e miratojmë me 2/3, janë disa çështje që duhet trajtuar me kujdes.

Armend Zemaj tha se nëse pajtohemi që ta çojmë këtë ligj duhet të fillojmë që tani, mirëpo ju e dini që kur kemi punuar edhe në rregulloren e punës, dhe ne patëm insistuar që të kemi Ligj për Kuvendin në mënyrë që aty të inkorporohen një pjesë e rregullores së punës dhe ligjit për deputet. Mirëpo sipas disa interpretime që i kemi ngritur kemi vlerësuar që fillimisht duhet të ndryshojë Kushtetuta nëse mendohet të miratohet ligji për Kuvendin, sepse në Kushtetutë decidivisht thuhet që “ rregullat e punës së Kuvendit, organizimi i brendshëm dhe mënyra punës rregullohen me rregulloren e punës së Kuvendit që miratohet me 2/3 e votave”. Edhe projekti i binjakëzimit ka sugjeruar që të vazhdojmë me rregulloren e punës dhe mos të kemi Ligj për Kuvendin. Unë kam qenë ithtarë që të kemi ligj për Kuvendin edhe pse shumica e shteteve nuk kanë, prandaj këtë çështje duhet ta trajtojmë me kujdes, kur e dimë që nëse trajtohet si një Ligj i thjeshtë duhet miratohet me shumicën e votave, kurse rregullorja si akt më i ulët me miratohet me 2/3.

Ardian Gjini ndau mendimin se nuk është dashtë që vitin e fundit të legjislaturës të bëhet një ligj i tillë, sepse nuk duhet që ne të bëjmë ligj për veten.

Pas diskutimeve, kryetari propozoi që në muajin shkurt të futet si pikë e rendit të ditës çështja e Projektligjit për Kuvendin dhe të vendosim se si do t'i qasemi punës për këtë Ligj.

Meqë nuk kishte vërejtje të tjera, kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

Përfundim

Miratohet plani i punës së Komisionit për Legjislacion, për vitin 2014.

5. Shkresa e Kryetarit të Kuvendit që ka të bëjë me kërkesën për veprim bazuar në raportet e fundit të ekspertëve të TAIEX-it

Kryetari i njoftoi me përmbajtjen e shkresës së TAIEX-it drejtuar Kryetarit të Kuvendit, të cilët kanë kërkuar që të ndikohet në Këshillin Gjyqësor të Kosovës që të mos lejohet që të trajtohen lëndët nga kolegji i Gjykatës së Apelit pa mbajtur séance publike dhe pa ekspertizë profesionale. Ai tha së në momentin kur ne po kërkojmë raport nga Këshilli Gjyqësor po thuhet që mos të bëhet ndërhyrje në sistemin e drejtësisë, kurse tani me këtë shkresë kërkohet që në të ndikojmë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Ardian Gjini propozoi që të formohet një grup punues për monitorimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës ku do t'i analizojnë dhe këtë material që sot e kemi para vetes.

Kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

Përfundim

I. Formohet Grupi punues për monitorimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në këtë përbërje:

Arsim Bajrami – kryesues,
Armend Zemaj - anëtar dhe
Sreten Ivanoviq-anëtar.

II. Obligohet grupi punues që gjatë punës së tij ta ketë për bazë edhe shkresën e TAIEX-it lidhur me çështjet e ngritura.

6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës

Kryetari paraqiti vërejtje në amendamentin 11 ku thuhet se “Nëse Qeveria, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditësh, nuk vepron në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, Kuvendi riemëron anëtarin e Komisionit “, vlerësoi se mënyra më të cilin është përcaktuar që me automatizëm të riemërohen kandidatet është shkelje e të drejtave të njeriut.

Meqë nuk kishte vërejtje të tjera, kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

Përfundim

1. Projektligji Nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Mbrojtjen e konkurrencës ka bazë kushtetuese për procedim të mëtejshëm.

1. Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohen për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare, përveç amendamentit 11.

7. Të ndryshme

a. Shkresa e shoqërisë civile për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit Nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre

Komisioni për Legjislacion, e shqyrtoi shkresën e Shoqërisë Civile për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit Nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre dhe vendosi që shkresa t'i procedohet Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si Komision FunkSIONAL.

b. Njoftim me ekspertizën e Idriz Tahirit për PL për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-050 për deklarimin prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë.

Kryetari i njoftoi me përmbajtjen e ekspertizës për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-050 për deklarimin prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, të ekspertit, z. Idriz Tahiri, e cila ju është shpërndarë së bashku me materialin për këtë mbledhje dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje para se të procedohet tutje.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetari Konstatoi se Konfirmohet përfundimi ekspertizës sipas kushteve të përcaktuara në termat e referencës.

c. Njoftim me ekspertizën e Besim Kelmendit për Projektligjin për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës ose të panelit për lirim me kusht

Kryetari i njoftoi me përmbajtjen e ekspertizës për Projektligjin për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës ose të panelit për lirim me kusht, të ekspertit, z. Besim Kelmendi, e cila ju është shpërndarë së bashku me materialin për këtë mbledhje dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje para se të procedohet më tutje.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetari konstatoi se konfirmohet përfundimi ekspertizës sipas kushteve të përcaktuara në termat e referencës.

d. Shkresa e Komisionit për Buxhet dhe Financa për projektligjin për deputet.

Kryetari, i njoftoi me shkresën e Komisioni për Buxhet dhe Financa i datës 22.1.2014, të cilët janë përgjigjur në kërkesën e Komisionit për Legjislacion të datës 16.12.2013, ku kemi kërkuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa të bëjë vlerësimin e kostos financiare (buxhetore) të Projektligjit për deputet. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka theksuar se Komisioni për Legjislacion duhet të kërkojë nga Drejtoria për Buxhet dhe Pagesa e Administratës së Kuvendit të hartojë deklaratën financiare për ndikimin buxhetor të Projektligjit.

Meqë nuk kishte diskutime të tjera, kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

Përfundim

Kërkohet nga Drejtoria për Buxhet dhe Pagesa e Kuvendit të hartojë deklaratën financiare për ndikimin buxhetor të Projektligjit për deputet.

Mbledhja përfundoi në orën 12:35

E përgatiti

Stafi mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit
Arben Gashi